



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale
Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Kur duhet të njoftohet?

Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë.

1.1 - Të dhënat e subjektit kontrolluesit

Ku duhet të njoftohet?

Kontrolluesi duhet të njoftojë për fillimin e aktivitetit të përpunimit të të dhënave pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ky formular plotësohet në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit www.kmdp.al dhe pas plotësimit, të dhënat ngarkohen në sistemin e brendshëm të institucionit, ku vijojnë procedurat e brendshme institucionale.

Në rast pamundësie të plotësimit dhe dërgimit online të formularit ju mund ta printoni nga faqja jonë ose ta tërhiqni atë pranë zyrës tonë dhe ta dërgoni me postë.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndodhet në Tiranë, në Rrugën "Abdi Toptani", nr.4, Kati i dytë.

Përrjashtimet nga detyrimi për njoftim

Në bazë të nenit 21 të ligjit Nr. 9887 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", përjashtohet nga detyrimi për tu njoftuar:

- Përpunimi i të dhënave personale, me qëllim mbajtjen e një regjistri, i cili, në përputhje me ligjin ose aktet nënligjore, siguron informacion për publikun në përgjithësi.

- Të dhënat personale që përpunohen, me qëllim mbrojtjen e institucioneve kushtetuese, të interesave të sigurisë kombëtare, politikës së jashtme, interesave ekonomikë ose financiarë të shtetit, apo për parandalimin e ndjekjen e veprave penale.

- Rastet e tjera, për të cilat njoftimi nuk është i nevojshëm, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka prioritet vendosjen e gjobave, por shkronja "d" e nenit 39 të ligjit parashikon sanksione, "vendosjen e gjobës" nëse nuk zbatohen kërkesat e parashtruara më sipër.

Ligji "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"

Çfarë parashikon ligji në lidhje me njoftimin e përpunimit të të dhënave personale?

LIGJI “PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE”

Çfarë parashikon ligji në lidhje me njoftimin e përpunimit të të dhënave personale?

Mbrojtja e të Dhënave Personale

Ligji “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” parashikon si objekt të tij përcaktimin e rregullave për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Fusha e zbatimit të ligjit është përpunimi i të dhënave personale, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike, si dhe përpunimi me mjete të tjera të të dhënave personale, që mbahen në një sistem arkivimi, sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Ligji gjen zbatim tek të gjitha institucionet publike e private si dhe tek individët, kur ata përpunojnë të dhëna personale, me përjashtim përpunimin e të dhënave nga një person fizik për qëllime thjesht personale apo familjare.

Detyrimi për njoftim

Ligji “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”

Në bazë të Ligjit mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **Njoftimi për Përpunimin e të Dhënave** nga **Subjektet Kontrollues** nëpërmjet një Formulari, është detyrim ligjor.

Në bazë të Ligjit të sipërpërmendur **“Kontrollues”** është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak, kontrollojnë të dhëna personale. Sipas këtij Ligji, mospërmbyshja e detyrimit për njoftim konsiderohet shkelje administrative.

Njoftimi, nëpërmjet formularëve, është një proces me anën e të cilit kontrolluesit e të dhënave personale njoftojnë **“Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”**, në lidhje me të dhënat që ato përpunojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre. Ky informacion i dhënë nga kontrolluesi, i parashtruar gjatë plotësimit të rubrikave të formularit, do të pasqyrohet nga Zyra e Komisionerit në një **Regjistër** i cili do të jetë i hapur për publikun në faqen zyrtare: www.idp.al. Janë të detyruar të njoftojnë të gjithë Kontrolluesit e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, Misionet Diplomatike ose zyrat konsullore të Shtetit Shqiptar, Kontrollues të cilët nuk janë të vendosur në Republikën e Shqipërisë, por që e ushtrojnë veprimtarinë nëpërmjet përdorimit të çdo mjeti që ndodhet në Republikën e Shqipërisë.

Qëllimi i njoftimit

Qëllimi primar i njoftimit dhe pasqyrimi i informacionit në këtë regjistër është transparenca ndaj publikut. Bërja me dije ose mundësia që i jepet publikut për t’u informuar se kush përpunon të dhëna personale, si dhe detaje të tjera të procesit, si p.sh., qëllimi i përpunimit, është një parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale. Plotësimi i formularit të njoftimit i shërben gjithashtu jo vetëm Komisionerit në lidhje me aktivitetin e tij ligjor por edhe vetë kontrolluesve për të siguruar një nivel të lartë transparence dhe besueshmërie tek subjektet e të dhënave personale.

Dokumenti i njoftimit

Njoftimi për fillimin e përpunimit të të dhënave personale bëhet me anë të formularit për njoftim. Formularin për njoftim bashkë me udhëzuesin e tij mund ta gjeni online pranë faqes tonë të internetit ose mund ta tërhiqni dorazi pranë zyrës së Komisionerit.

Formulari është konceptuar në 10 rubrika për t’u plotësuar nga subjektet kontrollues.

Erëndësishme: Formulari nuk do të pranohet i paplotë, i palexueshëm, me gabime dhe jashtë standardit të kërkuar.

Bëni kujdes që përpara se të plotësoni çdo rubrikë të tij, të saktësoni nëse është hera e parë e njoftimit apo njoftimi bëhet në vijim për të deklaruar ndonjë ndryshim të qëllimit të përpunimit apo të çdo informacioni të paraqitur herën e parë.

Çfarë parashikon ligji në lidhje me njoftimin e përpunimit të të dhënave personale?